

**ADMINISTRIMI I SHQIPËRISË NGA KOMISIONI NDËRKOMBËTAR I
KONTROLLIT 1913-1914**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË HISTORI E KOHËS SË RE**

NGA

FLAMUR BASHA



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

SHTATOR, 2021

EKSPOZE E TEMËS
ADMINISTRIMI I SHQIPËRISË NGA KOMISIONI NDËRKOMBËTAR I
KONTROLLIT 1913-1914

Mentor:

Prof. Dr. Gazmend Rizaj

Kandidati:

Flamur Basha

Populli shqiptar, pothuajse në tërë historin e tij të ekzistencës e ka kaluar nën pushtim e okupim nga perandori e shtete të ndryshme, që për kohën ishin superfuqi. Mirëpo, padyshim fillimi i shekullit XX, si për Gadishullin Ballkanik e mbi të gjitha për Shqipërinë, shënon një kthesë të madhe në histori. Kur vendosa të trajtoj këtë temë që përkon me periudhën ndër më të rëndën për popullin shqiptar në historinë e saj, por edhe pa asnjë mëdyshje, besoj që është edhe periudha më e rëndësishme fillim shekulli XX, kur pas shumë shekuj u jetësua qëllimi i pavarësisë së Shqipërisë dhe njohjes së saj ndërkombëtare. Isha i vetëdijshëm, që aspekti i trajtimit të ngjarjeve të bëhet në mënyrë sa më faktike e argumentuese, duke pasur parasysh faktin që ndonëse si trajtim kam vetëm vitet 1913-1914, është e mbushur përplot me ballafaqime e rrjedhje të ngjarjeve.

Pikërisht ecuria e ngjarjeve mbi çështjen shqiptare gjatë viteve 1913-1914, është edhe tema esenciale e këtij punimi i cili është i ndarë në kapituj të ndryshëm në bazë të rrjedhjes kronologjike të tyre.

Metodologjia e përdorur në realizimin e këtij studimi është metodologjia hulumtuese, analitike dhe përshkruese. Të gjitha këto metoda të shfrytëzuara për të arritur realizimin e këtij punimi, përkojnë me rendin kronologjik dhe ecurinë e ngjarjeve si dhe në respektimin e tyre.

Pra, në vartësi nga tematika e ngjarjeve dhe ecurin e tyre që e kam trajtuar, ky punim është i ndarë në kapituj të ndryshëm. Pas pjesës hyrëse, vijojnë kapitujt: “*I. Çështja shqiptare në Konferencë e Ambasadorëve në Londër (1912)*”, “*II. Qeverisja ndërkombëtare e Shqipërisë*”, “*III. Rëndësia dhe pasojat ndërkombëtare të Konferencës*”.

Në kapitullin e parë i cili titullohet: “*Çështja shqiptare në Konferencë e Ambasadorëve në Londër (1912)*”, trajton fillimisht zanafillën e organizimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Organizimi i kësaj konference ndërkombëtare në faktë, kishte ardhur si rezultat i ecurive të ngjarjeve në Evropë e specifikisht në Gadishullin Ballkanik. E padyshim, çështja kryesore e cila mori vëmendjen kryesore të diskutimit ishte: Çështja e shtetit shqiptar dhe e ardhmja e tij (Statuti i Shqipërisë; Organizimi i brendshëm dhe Çështja e kufijve). Në vazhdim të këtij kapitulli, është shtjelluar edhe ecuria e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë, proces i cili pa asnjë dyshim përbënë çështjën më të ndjeshme të trajtuar në Konferencë. Kjo është e lehtë të vërtetohet, vetëm duke u mbështetur në ecurin e diskutimit e më pas edhe të përcaktimit të kufijve në teren. Në pjesën e fundit të këtij kapitulli, është trajtuar aspekti i organizimit të brendshëm të shtetit të ri shqiptar. Edhe pse shteti i ri shqiptar kishte dalur me një qeveri e kuvend pas shpalljes së pavarësisë, ajo nuk ishte njohur asnjëherë ndërkombëtarisht. Prandaj, Konferenca e Ambasadorëve kishte vendosur që në Shqipëri ta dërgonte një Komision Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili do ta kishte rolin qeverisjes së vendit me një mandat dhjetë (10) vjeçar, e së bashku me të do të përcaktohej një Princ ndërkombëtar për të qeverisur në Shqipëri.

Në kapitullin e dytë që mban titullin : “*Il. Qeverisja ndërkombëtare e Shqipërisë*”, trajton fillimisht vendimin e datës 29 korrik 1913, në bazë të së cilit në Shqipëri caktohet Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit për të qeverisur me vendimin. Ky komision kishte ardhur në Shqipëri në muajin tetor të vitit 1913, kurse si mision të përcaktuar të tij kishte krijimin e Principatës të Shqipërisë dhe kalimin e tranzicionit të vendit drejtë pavarësisë së plotë. Poashtu, çështja e delegatit të shtatë të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili në bazë të vendimit do të vinte nga populli shqiptar, por jo domosdoshmërisht nga Qeveria e Vlorës, përbënë një element të veçantë të trajtimit. Kjo nga fakti se, përcaktimi i përfaqësuesit shqiptar do të përcillej me mos pajtueshmëri nga Qeveria e popullësi, mirëpo ishte më tepër si figurë imponuese ndërkombëtare aty, siç ishte figura e Myfit Libohova që s’kishte përkrahje popullore. Vazhdimi i këtij kapitulli përcillet me raportet që përcillte Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. E ndonëse, Qeveria e Vlorës kishte dalur nga një Kuvend dhe kishte legjitimitet të plotë, ajo asnjëherë nuk gjeti përkrahje ndërkombëtare. Mos njohja ndërkombëtare e Qeverisë, kishte kulmuar me humbjen e pushtetit dhe kalimin e tij në duart e KNK-së, si rezultat i dy faktorëve: 1. Humbja e mbështetjes nga figura të fuqishme që deri më tani ishin në

krah të Ismail Qemalit, e tani e tutje e kishin përkrahur figurën e Esat Pashë Toptanit; II. Marrëveshja e I. Qemalit me Turqinë e Bullgarinë, rreth krijimit të një boshti të shteteve që ishin të pakënaqura me ndarjen e tokave pas Luftës së Parë Ballkanike. Kurse, në pjesën e fundit të kësaj kaptine është e trajtuar çështja e përcaktimit të Princit në Shqipëri dhe formimit të qeverisë definitive ndërkombëtare në vend. Ndonëse, për pozitën e princit të Shqipërisë kishin synuar mbi shtatëmbëdhjet figura, figura e princit gjerman Vilhem Vidit, ishte përzgjedhur pas propozimit nga Austro-Hungaria e Italia, si personaliteti që do ta udhëheqte Shqipërinë së bashku me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit. Pasi kishte marrë pushtetin në vend, Princ Vidi kishte formuar qeverinë e tij që vinin nga popullsia shqiptare, mirëpo në qeverinë e tij pushtet kishin zënë edhe personalitete të ndryshme ndërkombëtare, të afërm me princin.

Në kapitullin e tretë dhe të fundit të këtij disertacioni, që mbanë titullin: *‘‘III. Rëndësia dhe pasojat ndërkombëtare të Konferencës’’*, fillimisht trajton çështjen e vendosjes në Shqipëri të Statutit Organik (ligjit i parë themeltar i Shqipërisë), i hartuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit e që ishte bazuar në vendimet e datës 29 korrik 1913, të Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Në bazë të këtij statuti, që llogaritej si kushtetutë e kohës: Shqipëria përcaktohej si Principatë kushtetuese e sovrane dhe e trashëgueshme, nën garancinë e Fuqive të Mëdha. Pastaj, në vazhdim të kësaj kaptine trajtohet çështja e organizimit të Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme (1914), kryengritje e cila synim kryesor e kishte marrjen e pushtetit në vend nga forcat e Esat Pashë Toptanit. Padyshim, këto forca anti-shqiptare të përkrahura nga shtetet fqinje që synim jetësor e kishin eliminimin e popullsisë shqiptare, apo thënë shkurtimisht, shkatërrimin e asaj të ndërtuar ndër vite në vend. Kjo kaptinë në fund përmbyllet me rënien e pushtetit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (1914), si pasojë e dy faktorëve që dërguan në abdikimin e Princ Vidit nga pushteti: I. Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme; II. Fillimi i Luftës së Parë Botërore. E sigurisht pasojat ishin të rënda për popullësinë dhe shtetin e ri të sapo krijuar shqiptarë. Kjo dëshmohet edhe me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, ku territoret e shtetit shqiptar shiheshin vetëm si zgjidhje kompromisi në mes shteteve ballkanike dhe Superfuqive të kohës. Ato ishin shndërruar në plaçkë gllabëruese, vetëm e vetëm për t'i kënaqur apetitet e shteteve, kurse shteti i ri shqiptar nga kjo Konferencë kishte dalur me pak territore, pjesa më e madhe e së cilës ishin lënë jashtë saj.

Në fund të punimit, si zakonisht janë dhënë edhe konkluzionet e ndryshme ndër të cilat i veçojmë:

- Organizimi i Konferencës së Londrës kishte një rëndësi të veçantë mbi Shqipërinë dhe shtetin e ri të krijuar. Organizimi i saj, solli njohjen ndërkombëtare të shtetit të Shqipërisë.

- Ndonëse kishte pakënaqësi rreth organizimit të brendshëm të pushtetit në vend, e që nuk sigurohi njohje ndërkombëtare Qeveria e Përkohshme e Vlorës, ajo prapë se prap hoqi dorë nga pushteti, vetëm e vetëm që Shqipëria ta ruante pavarësinë e fituar nga Konferenca.

- Administrimi i Shqipërisë nga Princ Vidi e Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, ndonëse nuk kishin arritur të realizonin atë që e kishin premtuar në vend, asnjëherë nuk u la pa përkrahje nga popullsia shqiptare e cila ndonëse e pakënaqur, nuk hoqi dorë e madje u ngritë në këmbë të luftonte forcat esatiste të përkrahura nga shtetet fqinje, vetëm që ta mbanin gjallë Shqipërinë.

- Përfundimisht edhe pse Shqipëria ishte copëtuar, ku shumica e territoreve etnike të saja kishin mbetur jashtë trungut. Shpallja e Pavarësisë, Organizimi i Konferencës së Ambasadorëve në Londër, ngritja e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit për ta qeverisur vendin, caktimi i Princit ndërkombëtar të vend etj, përbëjnë një epokë të ndritur për popullin shqiptarë. Ëndërr e cila është përcjellur ndër breza, pavarësia e njohja ndërkombëtare për vendin ishte realizuar.

